



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:278147

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06342445

C.nr.2851/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit S.D., nga Peja, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Filloreta Hoxha-Zymberaj, avokate në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „....”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit: 32.475€, në shqyrtimin e mbajtur me dt.17.10.2024, në prezencën të autorizuarës së palës paditëse, e në mungesë të autorizuarit tjetër të paditurës, me dt.22.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S.D., nga Peja, ashtu që:

I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „....”, me seli në Prishtinë, që në emër të *dëmit jo material dhe material* të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt.15.06....., në bazë të auto përgjegjësisë, paditësit S.D., nga Peja, t’ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë, dhe atë:

- për zhdëmtimi në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 4.000€,
- për zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 6.000€,
- për zhdëmtim në emër të frikës shumën prej 6.000€,
- për kujdes dhe ndihmë të huaj, shumën prej 560€
- për ushqim të përforcuar shumën prej 840€
- për terapi fizikale shumën prej 280€,
- për zhdëmtim në emër të shpenzimeve mjekësore shumën prej 165€,

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit S.D., nga Peja përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material dhe material, dhe atë shumat e specifikuar si në vijim: në emër të zhdëmtimit: për ushqim të përforcuar shumën prej 420€, dhimbje fizike, për zvogëlimin e aftësisë punuese, shumën prej 1.000€, për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000€, për zhdëmtimin në emër të frikës shumën prej 1.000€, dhe për terapi fizikale shumën prej 280€, për shpenzimet mjekësore shumën prej 110€, si dhe për rehabilitim të fiziatrisë shumën prej 280€ SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „....”, me seli në Prishtinë, që paditësit S.D., nga Peja për shumat e gjykuara si në pjesën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga dt.22.10.2024, si ditë e vendim marrjes e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „...”, me seli në Prishtinë, që paditësit S.D., nga Peja t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.713,40€, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

A r s y e t i m

Paditësi me padi, precizimin e bërë më dt.29.08.2024, në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e nëpërmjet të autorizuarës së tij, ka parashtruar se me dt.15.06...., rreth orës 11:30 në Pejë, në mes të automjetit-kaminonit të Higjienës Publike dhe një këmbësori, këtu paditësit, ashtu që kamioni e ka goditur këmbësorin nga prapa dhe nga ky aksident, i njëjti ka pësuar lëndime të rënda.

Ka cekur se shakatar i këtij aksidenti ka qenë i siguruari i të paditurës, të cilës paditësi i është drejtuar me kërkesë për kompensimin e dëmit, në kuptim të Rregullores mbi procedurën e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve, që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia, ku e paditura pas trajtimit të rastit, nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadiës, dhe komisioni i saj për vlerësimin e dëmeve ka ofruar një kompensim të dëmit material, por të pakënaqshëm për paditësin, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve...

Në mes të ndërgjyqësve ka theksuar që nuk është kontestuese se shkaktori i aksidenti..., andaj lind dhe obligimi i të paditurës që ta paguaj shpërblimin për dëmet e shkaktuara në këtë aksident...në të cilin paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, të argumentuara me raporte mjekësore, të kryera në klinika të ndryshme. Gjatë lëndimit, paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë, dhe ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, ka pasur zvogëlim të aftësisë së punës dhe të aktivitetit të përhershëm jetësor. Ka propozuar administrimin e provave, nga padia.

E autorizuara e paditësit pas nxjerrjes së ekspertizave ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, me dt.29.08.2024, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka refuzuar ofertën e dhënë nga e paditura, për mbylljen e çështjes në tërësi në shumë prej 8.000€, dhe shpenzimet procedurale, bazuar në lëndimet e rënda trupore.

Në fjalën e saj përfundimtare ka ritheksuar se mbetet në tërësi pranë padiës dhe precizimit të saj, me arsyetim se me provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadiës, se deri tek aksidenti ka ardhur me fajin e të siguarit të të paditurës, dhe se kërkesa e padiës është reale dhe proporcionale me mendimin e ekspertëve dhe Rregulloren e dëmeve materiale si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme, i nxjer në harmoni me LMD-në.

Gjykatës, i ka propozuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadinë, e precizuar si në parashtrësën e dt.29.08.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padiës shumë prej 208€ (për shkak të vlerës së kontestit mbi 10.000€), për taksë gjyqësore shumë prej 101€, për tri seanca të mbajtura nga 270.40€ për seancë, shumë prej 811.20€, për një seancë të shtyrë shumë prej 135.20€, për precizimin e kërkesëpadiës shumë prej 208€ dhe për shpërblimin për ekspertizë shumë prej 250€, e në shumë të tërësishme prej 1.713,40€.

E paditura me përgjigje në padi të ushtruar me dt.28.09.2023, pjesërisht e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj, duke e kundërshtuar vetëm lartësinë e kërkesëpadiës.

Ka theksuar se nga pala paditëse ka kërkuar që të paraqitet në zyre të saja, për ekzaminim të drejtpërdrejtë, mirëpo e njëjta ka refuzuar ekzaminimin.

Se palës paditëse pas ekzaminimit të shkresave që i ka poseduar, për dëmin material dhe jo material, i ka ofruar ofertën në shumë prej 3.649,50€, si dhe shpenzimet procedurale jashtëgjyqësore, sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Gjatë shqyrtimit kryesor nuk kanë marrë pjesë, por me parashtrësën për seancën e dt.17.10.2024, ka dhënë edhe fjalën përfundimtare, duke ofruar ofertën prej 8.000€, për të gjitha

kategoritë e dëmit dhe shpenzimet e njëjta, mirëpo ka cekur se kjo ofertë është refuzuar në tërësi si e pabazuar. Ka kërkuar që shpenzimet procedurale të aprovohen në bazë të suksesit në procedurë, dhe të njëjtat pala e paditur nuk i kërkon.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, këtë çështje juridike, zhvilloi procedurën e provave në të cilën u lexua dhe u shiqua si provë: raporti policor i dt.15.06...., fletë lëshimi me epikrizë i dt.22.06...., raporti psikiatrik nga Ortho-Spine i dt.28.06...., raporti mjekësor nga Spitali „Aloka” i dt.25.08..., fatura e dt.17.09...., raporti nga kirurgu Dr.Burim Ukperaj i dt.17.09.20..., raporti nga Internacional Hospital i dt.17.09.20..., raportet nga Dr.Florim Bajraktari, Dr.Skender Boshtraj, raporti nga Emergjencia në Prishtinë, i dt.22.06...., raporti nga „Biohit” i dt.08.07..., tetë dëftesë-pagesa të bëra në QKMF, deklaratat e autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.

Pasi gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç e në lidhmëni njëra me tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me administrimin e provave gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se me dt.15.06...., ka ndodhur aksidenti i trafikut, ku shkaktar i këtij aksidenti, sipas raportit policor të dt.15.06...., me nr. të rastit 2021:DR-..., ishte i siguruari i të paditurës M.P., nga fshati D., Komuna e P..

Është vërtetuar edhe fakti se paditësin S..e ka goditur kamioni i Higjenës Publike, në atë mënyrë që deri sa ishte duke lëvizur rrugës paditësi në cilësinë e këmbësorit, kamioni i cekur duke u shtyrë prapa, e godet këmbësorin-paditësin S., me ç’rast i ka shkaktuar lëndime trupore dhe atë:

-frakturë të pjesës proksimale të fibulës së majtë, gërvishtje të kërcirit të majtë, pastaj hematom(mbledhje e gjakut) në regjionin e mesëm të kërcirit të majtë ana laterale, si dhe nga rezonanca magnetike e gjurit të majtë, ruptur e (shqyrje) e miniskusit medial, briri i pasmë i gjurit të majtë, me ç’rast paditësit është dashtë që për shkak të hematomës apo mbledhjes së gjakut në regjionin e kërcirit të majtë, t’i behet incizionin-evakujimin i hematomës, dhe nga ky vend ka mbetur hernija muskulare, e cila vërehet me gjatësi 6 cm, ku kërciri është i fryrë, për shkak të hernies muskulare, ekspertja Dr. Vjollca Binqe, ortopede-traumatologe, këto lëndime i ka gjetur si lëndime të rënda trupore.

Paditësi menjëherë pas aksidentit është dërguar në Spitalin Regjional në Pejë, prej ku është transferuar në QKUK-Prishtinë, për çka posedon raportin mbi transferimin, e pastaj ka vazhduar shërimin nëpër spitale të tjera, për çka posedon raportet mjekësore me raport fiskal...që vërtetojnë faktin se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën mjekësore të specializuar, pasi që për shkak lëndimeve trupore ka përjetuar dhimbje dhe frikë...

Gjykata Themelore në Pejë, ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë (për të cilën në shkresat e lëndës ka mjaft prova që e vërtetojnë të njëjtën), por vetëm lartësia e saj, atëherë gjykata provat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e shkaktarit respektivisht provat që argumentojnë bazën juridike të kërkesë padisë, nuk i vlerësoi fare, por vetëm i mori parasysh, pasi që të njëjtat ishin jokontestuese, dhe atë bazuar në dispozitat e nenit 321 par. 2 të LPK-së, me të cilën parashihet që faktet e pohuara nga pala para gjykatës, gjatë procesit gjyqësor nuk kanë nevojë të provohen.

Gjykata përkundër të cekurave, konstaton se baza juridike e kërkesës që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar paditësin gjen mbështetje në dispozitat e nenit: 136, 137, 140, 159.1, 179.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së). Me dispozitivin e nenit 136 parashihet se kush i shkaktonte dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë atë përveç nëse vërtetohet

se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, me dispozitën e nenit 137 parashihet se dëmi është zvogëlim i pasurisë ose pengim i saj dhe shkaktimi i dhimbjes ose frikës së përjetuar, me dispozitën e nenit 140 thuhet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia, me nenin 159.1 parashihet se në qoftë se dëmi është shkaktuar nga automjeti në lëvizje dhe për fajin e vetëm të një zotëruesi vihen në zbatim rregullat e përgjegjësisë mbi bazën e fajit, me nenin 179.1 parashihet se kush i shkaktonte tjetrit lëndim trupor ose i'a dëmton shëndetin ka për detyrë t'ia shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike, Gjykata më konkretisht për vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë, sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga grupi i ekspertëve të gjykatës: Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër, dhe Dr.Vjollca Binçe, ortopede-traumatologe, të cilët në mënyrë më meritore dhe profesionale në seancën e dt.27.08.2024, kanë dhënë mendimin e tyre, dhe janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi në aksidentin e përmendur.

Eksperti Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër, pas ekzaminimit direkt ka konstatuar se: paditësi ka përjetuar frikë dhe atë:

- primare në kohëzgjatje prej disa sekondash (kjo periudhë është përcjellë me shtangim afektiv dhe frikë nga vdekja e drejtë për drejtë).

-sekondare të intezitetit të lartë ka pasur në kohëzgjatje gjerë në tri orë, duke e llogaritur kohën nga momenti i aksidentit, dërgimin i tij në Qendrën Emergjente të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, ku janë bërë egzaminimet dhe rehabilitimi mjekësorë (kjo periudhë është e përcjellë me të rrahura të shpejtuara të zemrës frymarrje të vështirësuar, dridhje të muskujve dhe ankesa të tjera trupore.),

-sekondare me intensitet të mesëm, ka pasur në periudhën kohore gjer në tre muaj, të manifestuar me një çrregullim afektiv afatgjatë, si pasojë e aksidentit (si pengesa të herë pas hershme në gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike, indisponim dhe pengesa të tjera trupore shkallë më të ultë të tolerancës frustrative, kufizim të pjesshëm në aktivitetet e përditshme jetësore, frikë nga invaliditeti i mundshëm dhe pengesa të tjera somatike), dhe

-frikë sekondare me intezitet të ultë ka pasur në periudhën kohore gjerë në 6 muaj (e që manifestohet gjatë kohës kur ka dal në komunikacion, dhe situatat të cilat ja rikujtojnë ngjarjen).

Ekspertja Dr.Vjollca Binçe-ortopede-traumatologe, pas ekzaminimit direkt ka konstatuar se: paditësi ka pësuar lëndime trupore dhe atë: bazuar në raportet mjekësore të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në raportin-fletë lëshimi i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, me Nr.35., ku ka qëndruar prej dt.15.06... e deri me dt.22.06...., pastaj raporti i rezonancës magnetike të gjurit të dt.25.08.2021, si dhe raportet përcjellëse të lëshuara nga ortopedi dhe kirurgu vaskular si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit ka konstatuar se i njëjti ka pësuar këto lëndime trupore:

-frakturë të pjesës proksimale të fibules së majtë, gërvishtje të kërcirit të majtë, pastaj hematom (mbledhje e gjakut) në regjionin e mesëm të kërcirit të majtë ana laterale si dhe nga rezonanca magnetike e gjurit të majtë, rupturë e (shqyerje) e miniskusit medial, briri i pasmë i gjurit të majtë. I njëjti për shkak të hematomës apo mbledhjes së gjakut në regjionin e kërcirit të majtë është detyruar të bëjë incizionin-evakujimin e hematomës, dhe nga ky vend ka mbetur hernija muskulare e cila vërehet me gjatësi 6 cm, ku kërciri është i fryrë për shkak të hernies muskulare, duke potencuar se këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore.

Ekspertja ka përfunduar se i aksidentuari-këtu paditësi, në këtë aksident ka përjetuar dhimbje dhe atë: të intezitetit:

-posaçërisht të rëndë, në periudhë kohore prej një ore, përfshirë ndodhjen e aksidentit, transportimin, realizimin e ekzaminimeve klinike dhe dhënies së analgetikëve.

-të rëndë kanë zgjatur edhe për tri orë kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes.

-të mesëm kanë zgjatur edhe për njëzete një ditë dhe atë dhimbje kryesisht në regjionin e gjurit të majtë dhe pjesës së hematomës.

-të intensitetit të ulët posedon akoma në ecje të gjata, ecje në shkallë, ngarkesa, pra bartje të peshës dhe ndërrime klimatike.

Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është 9% dhe atë për shkak të kontrakturës së gjurit, me shqyerje të miniskusit të bririt të pasmë dhe për shkak të hernies muskulare, të cilat përlllogaritur me formulë të Balltazarit japin përqindjen prej 9%.

Paditësi ka shëmtim trupor të shkallës së ulët, për shkak të vrajave të mbetura në regjionin e kërcit të majtë me gjatësi: njëra 4x0.5 dhe tjetra me gjatësi 5x0.5, dhe me fryrje e që vërehen në stinët e ngrohta.

Paditësit i është nevojitur ndihma nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 4 jave, dhe atë në ndihmë për mbajtjen e higjienës personale, kontrollet mjekësore dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore.

Paditësit i është nevojitur ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javë, i pasur me proteine, minerale dhe vitamine.

Paditësit i është nevojitur terapia fizike në kohëzgjatje prej 14 ditësh, për përforcimin e muskullit të regjionit të gjurit të majtë.

Ekspertja ka dhënë mendimin se faturat mjekësore në shkresat e lëndës, i përgjigjën mjekimit, si pasoj e aksidentit në fjalë, dhe se lëndimet e paditësit janë të karakterit të përhershëm-invaliditeti është i përhershëm.

Gjykata në tërësi i ka pranuar mendimet profesionale të dy ekspertëve në fjalë, të njëjtave ju fali besimin në tërësi, pasi që të njëjtat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, dhe janë në harmoni me provat që gjithashtu janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, e të cilave i'a shtojmë dhe faktin se pala e paditur nuk ju ka bërë vërejtje, për çka gjykata konsideron se ky mendim i ekspertëve është i pa kontestueshëm.

Gjykata për lartësinë e kërkesëpadisë, për kategoritë e cekura të dëmit jo material vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 183 të LMD-së, e lidhur me nenit 323 të LPK-së, pra duke marrë për bazë gjithmonë rendësin e shkeljes së të mirës, qëllimit që i shërben kompensimi i gjykuar, duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarit, e nën supozimin se kompensimi i gjykuar do të ndikoj në zbutjen e pasojave negative që i janë paraqitur paditësit si rezultat i dëmtimeve të pësura në aksident, pra gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke marrë për bazë natyrën dhe shkallën e lëndimeve, pasojave dhe frikës intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, vendosi si në pjesën aprovuese të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i caktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi-pjesa aprovuese, për paditësin nuk është shpërblim i plotë, mirëpo është satisfaksion dhe i drejtë për te, andaj edhe është vendosur si në pjesën aprovuese, ndërsa përtej shumës së aprovuar për kategoritë e dëmit jo material dhe material si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit, gjykata refuzoi shumat dhe atë:

-për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1.000€, për zhdëmtimin në emër të frikës shumë prej 1.000€, për zhdëmtimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 1000€, për ushqim të përforcuar shumë prej 420€, dhe për terapi fizikale shumë prej 280€, dhe për shpenzimet e mjekimit shumë prej 110€, SI E PA BAZUAR, për faktin se shpërblimi i dëmit jo material dhe material nuk mund dhe nuk duhet t'i shkojë përshtati synimeve të padrejta, dhe vlerësoi si të pa drejtë shumë e kërkuar përtej shumës së aprovuar, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh të gjitha pretendimet e palës paditëse në kuptim të pretendimeve nga padia dhe ato gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin

me ndikim për një vendim ndryshe, për arsye se në rastin konkret me provat prezent në lëndë është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, në kuptim të dispozitave të cekura më lartë.

Në rastin konkret me provat e administruara nga gjykata sipas propozimeve të palëve, pala paditëse nuk mundi të argumentoi kërkesën e saj për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë.

Vendimi për kamatë gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ngase konsideron se nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit, pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, me arsyetim se nga ky moment e paditura kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit që i'a ka shkaktuar palës paditëse, andaj edhe është vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së, ashtu që e paditura është e obliguar që paditësit të i'a paguaj dhe atë: për përpilim të padisë shumë prej 208€ (për shkak të vlerës së kontestit mbi 10.000€), për taksë gjyqësore shumë prej 101€, për 3 seanca të mbajtura nga 270.40€ për seancë, shumë prej 811.20€, për një seancë të shtyrë shumë prej 135.20€, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 208€ dhe për shpërblimin për ekspertizë shumë prej 250€, shumë e tërësishme prej 1.713,40€.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.2851/21, me dt.22.10.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

*Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh,
pas marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
e përmes kësaj gjykate.*